



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.190 dt.29.09.2000

**“PER
KALIM NE FOND BANESE, PAJISJE ME AUTORIZIM DEFINITIV DHE
PRIVATIZIM TE OBJEKTIT TE NDERMARRJES SE PASTRIMIT TE
KUARTALLEVE QE NDODHET PRANE SHKOLLES “VASIL SHANTO””**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.29.09.2000, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Ndërtim Strehimit “Propozim për kalim në fond banese , pajisje me autorizim definitiv dhe privatizim të objektit të Ndërmarrjes së Pastrimit të Kuartalleve që ndodhet pranë shkollës “Vasil Shanto”, në zbatim të ligjit Nr.8652, dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, të Dekretit të Presidentit të Republikës Nr.1440, dt.04.04.1996 “Për banesat shtetërore”, të V.K.M. NR.49, dt.23.01.1993 “Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehët”.

V E N D O S I

1. Të kalojë në fond banese objektin e Ndërmarrjes së Pastrimit të Kuartalleve që ndodhet pranë shkollës “Vasil Shanto”. (sipas planit të vendosjes bashkangjitur.)
2. Të pajiset me autorizim definitiv për (1Dh+1K) qytetari Bedri Dano për këtë ambient në adresën e sipërpërmendur (sipas planimetrisë bashkangjitur) dhe ta privatizojë atë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Ndërtim Strehimit dhe N.SH.K.Banesa.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI